

MENAXHIMI I HUMBJEVE TË UJIT - II

Përshkrimi i kursit

Kursi i trajnimit mbi Menaxhimin të Humbjeve të Ujit II, vjen si një vazhdimësi e kursit të parë mbi Menaxhimin e Humbjeve. Ky kurs do të përshkruaj dhe shfaq nevojën e zbatimit të programeve të reduktimit të humbjeve duke theksuar gjithashtu rëndësinë e përmirësimit të efikasitetit tregtar në Shoqëritë UK nëpërmjet praktikave më të mira ndërkombëtare lidhur me matjen dhe treguesit e performancës së efikasitetit tregtar.



Pjesëmarrësit do të kuptojnë se pas investimeve të mëdha për ndërtimin apo rikonstruksionin e rrjetit të sistemit të furnizimit me ujë, kërkohet një menaxhim sa më i mirë, për të siguruar efikasitetin në operimin e sistemit dhe shërbime me kosto më të ulët.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësjellës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për drejtorët e departamentit teknik dhe të shpërndarjes, inxhinierët e mirëmbajtjes dhe të shfrytëzimit, inxhinierët e matjes, teknikët e bilancit, si dhe menaxherët e faturimit dhe arkëtimit.

Gjithashtu, ky kurs synon në mënyrë të vecantë pjesëmarrjen e profesionistëve të cilët morën pjesë në kursin e parë të Menaxhimin të Humbjeve të Ujit - I.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Njihni rëndësinë e menaxhimin të kërkesës për ujë dhe rëndësinë e matjes së ujit;
- Përcaktoni sasinë e prurjes dhe kërkesën për ujë në rastet kur nuk ka matës;
- Njihni rëndësinë e efikasitetit tregtar;
- Identifikoni nivelin ekonomik të ujit pa të ardhura;
- Shpjegoni rëndësinë e përcaktimit të përparësive ndërmjet komponentëve për reduktimin e ujit pa të ardhura;
- Kuptoni rëndësinë e përcaktimit të përparësisë ndërmjet komponentëve për reduktimin e ujit pa të ardhura;
- Plotësoni tabelën e bilancit të ujit;
- Planifikoni një fushatë ndërgjegjësimi për konsumatorët.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthurura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë raste konkrete duke u angazhuar në zhvillimin e ushtrimeve që përfshijnë përdorimin e të dhënave të shoqërisë së tyre.

Materialet e kursit të trajnimit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit "Menaxhimi i Humbjeve të Ujit II". Përpos kësaj, ju do të pajiseni me çertifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB/SHUKOS: 13,000 lekë për person

Jo-anëtarët: 16,000 lekë për person

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.